



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BULQIZE
NJËSIA E PROKURIMIT

Bulqize, më _____.____.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: *“Rehabilitim dhe sistemim i përroit të Thatë, Nj A, Fushë Bulqizë, Bashkia Bulqize.”*

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 45000000 - 7, Pune ndërtimi.

Vlera e fondit limit: 24 888 513 (*njzetë e kater milion e tetëqind e tetëdhjetë mijë e pesëqind e trembedhjetë*) lekë pa TVSH, e ndare perkatesisht ne dy vite per vitin 2024 me nje vlere prej 12 444 256.5 (*dymbedhjetë milion e katerqind e dyzete e kater mije e dyqind e pesedhjetë e gjashte pike pese*) leke pa tvsh dhe per vitin 2025 ne nje vlere prej 12 444 256.5 (*dymbedhjetë milion e katerqind e dyzete e kater mije e dyqind e pesedhjetë e gjashte pike pese*)Leke pa tvsh.

Referuar :Vkm nr 307, date 22.05.2024 “Per miratimin e projekteve fituese te financuara per vitin 2024 nga fondi per parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqesive natyrore, si dhe Autoritetit Kontraktor per zbatimin e projekteve, sipas njesive te qeverisjes vendore.

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti Kontraktor, **Bashkia Bulqize**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 7, gërma “ç”

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim për deklarimin e xhiros vjetore, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore) të tre viteve të mëparshme (**2021, 2022, 2023**), në të cilat duhet të rezultojë se vlera e xhiros minimale vjetore të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 1/b dhe 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 /b e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b** dhe **3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomike dhe financiare;**... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. **Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.**

Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, **kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të**

realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.”

2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:
b) vlerën e përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*

3. *Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2021**, **2022**, dhe **2023**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të *ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. 4. *Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit¹, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” (i ndryshuar).*

Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 2.2.1 dhe pika 2.2.2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitetin financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, (nuk kane detyrime te prapambetura) në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitetet sipas të dhënave të QKB-së.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020

“Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Bulqize, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 2.2.3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar),

Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se, bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të aktivitetit të operatorëve ekonomikë, duke qenë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, shlyerja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore duhet të vërtetohet nga secili anëtar.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më e vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.2 Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomik duhet të paraqesin:

Për plotësimin e këtyre kritereve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in si dëshmi, vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen

me sukses të kontratës, ku të shënohet vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, dokumentacionin e mëposhtëm:

- I. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- II. Situacionin përfundimtar të objektit*
- III. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
- IV. Aktin e Kolaudimit të objektit*
- V. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit*
- VI. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*

b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, Operatori/t Ekonomik duhet të të paraqesë/in si dëshmi, vërtetime për përmbushjen me sukses të kontratës, ku shënohet vlera, afati i përfundimtar të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, dokumentacionin e mëposhtëm:

- I. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- II. Situacionin përfundimtar të objektit*
- III. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
- IV. Aktin e Kolaudimit të objektit*
- V. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit*

Pika 2.3.1 germa “a” plotësohet nga anetari I cili ka përqindjen me të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anetaret e tjera të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anetare të një bashkimi, kanë të njëjten përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1. germa b duhet të plotësohet nga të gjithë anetaret e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim (neni 88 pika 3 e VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”)

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën

Plotësimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave,

*plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”*AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikavate sipërpermendura , të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: **”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.**

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përkrahur nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar ne Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: **”Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:** a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e sukseshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

AK ka kërkuar keto dokumenta ne perputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku ndër të tjera përcaktohet se: **”Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të**

kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”

2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në licensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Licensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Për punimet operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licensë:

- **NP-1 A** (Punime gjurmimi në tokë)
- **NP- 9B** (Punime dhe mbrojtje lumore)
- **NP- 12 B** (Punime te inxhinierise se mjedisit)
- **NS-9A** (Punime strukturore speciale)
- **NS-18 B** (Punime topogjeodezike)

** Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e licensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

*** Ne rast bashkimi operatorësh secili duhet të disponojë kategoritë e licensës sipas marreveshjes.**

Argumentimi: *Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është*

vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

N.P-1A (Punime gërmimi në tokë)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me gërmime në tokë (**konkretisht zerat me numer analize: 3.124/a , 3.106/b**) ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

– NP- 9B (Punime dhe mbrojtje lumore)

Duke marrë në konsideratë objektin e prokurimit, i cili lidhet me rehabilitimin dhe sistemimin e përroit (i cili sjell permbytje të zones) , vendosja e kesaj kategoria eshte e domosdoshme me qellim permbushjen me sukses te punimeve objekt kontrate konkretisht zerat e punimeve sipas preventivit me nr *analize 3.331 dhe 3.333.*

– NP- 12 B (Punime të inxhinierise se mjedisit)

Sikunder objekti i prokurimit ka ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis pasi kemi të bëjmë me një perrua i cili ka ndikim në zhvillimin e floras dhe faunas të zones ku kalon ky perrua, prandaj është e nevojshme që Operatori Ekonomik të jetë i licensuar për këtë kategori.

– NS-9A (Punime strukturore speciale)

Referuar projektit teknik është parashikuar një zgjidhje e mbrojtjes së përroit nëpërmjet inkastrimit të mureve gabion në njërën anë të skarpates së përroit, të cilët do të sigurojnë qëndrueshmëri në kësaj skarpate qofte në afteine mbajtese edhe në mosgerryerjen e saj nga rrjedha e përroit, prandaj është e nevojshme që Operatori Ekonomik të jetë i licensuar për këtë kategori.

– NS-18 B (Punime topogjeodezike)

Duke qenë se në projekt e preventiv janë parashikuar punime të natyrës topogjeodezike, vecanerisht (**proceset e punes per germim, zgjerim ose thellim te shtratit te perroit, piketim te sakte per vendosjen e mureve gabion , punimet e betonit etj, sipas preventivit**)dhe është e nevojshme zotërimi i kësaj pike license.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:

- a. Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO te sipercituar).
- b. Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO te sipercituar).
- c. Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO te sipercituar).

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomike, secili operator ekonomik duhet të paraqesë çertifikata ISO sipas zerave të punimeve që do të marrin për të realizuar sipas marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet operatorëve.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.4 janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin.. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrorjnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtarë, i cili parashton kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga

madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 sipas zerave te punimeve te marra persiper, me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën e nevojshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë licencën – **Kodi III.2.B - “Grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”**, referuar Vendim nr.538, datë 26.5.2009 për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), të vlefshme.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa se Operatortë ekonomike pjesëmarrës duhet te jene te pajisur me licence nga Qendra Kombetare e licensimit (QKL) Kodi III.2. B është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje te *Ligjit Nr. 9010, date 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta” (Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, date 11.05.2009 “Per disa ndryshime ne legjislacionin ne fuqi per licensat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise”)*.

Autoriteti Kontraktor gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **55 (pesedhjetë e pese) punonjës** për periudhën **3 (tre) muajt** e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe drejtuesit teknik, stafi mbështetës, specialistet dhe punetoret për realizimin ekesaj kontrate.

Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kriteri konsiderohet i permbushur me paraqitjen e formularit te vetedeklarimit sipas shtojces 8.Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit te ofertave duhet te dorezoje dokumentacionin provues per pikat 1 dhe 2.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. ç) **fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;**

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Raportit/Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej **55 (pesedhjetë e pese)** punonjësish është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj duke iu referuar **dhe perlllogaritjes teknike te kryer nga specialisti i fushes** bashkangjitur tabela e perlllogaritjes per makineri,punetori, sipas analizave teknike te manualit per cdo ze punimesh.Numri i vendosur per punonjesit i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shpëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj eshte kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.*

2.3.7.Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Librezë pune;
- b) Kontratë pune e vlefshme;
- c) Diplomë.

(Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet te përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishem gjate gjithë kohes qe do te kryhen punimet ne objekt ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas përqindjes se bashkepunimit).

2.3.8. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, **te përfshirë në licencën e shoqërisë**, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- Inxhinier ndertimi 1(nje)
- Inxhinier Topograf/Gjeodet/Marksheder 1(nje)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)
- Inxhinier mjedisi 1(nje)

2.3.9 Operatori/et ekonomik për realizimin e punimeve në objektin e kontratës, duhet të disponojë edhe punonjës të specializuar/kualifikuar me arsim të lartë dhe të mesëm si staf mbështetës. Specialistet të shoqërohen me kontrata pune, diplome/certificate, certifikate të vlefshme të figurimit teknik të figurojë në listpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit .

- Inxhinier ndertimi profili gjeoteknik 1(nje)

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetedeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vlerësimit të ofertave duhet të dorëzojë dokumentacionin provues.

Argumentimi: *Së pari*, kjo kërkesë mbështetet në **Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.**

Së dyti, duke qenë se objekt i prokurimit është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi **Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”**, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: *“drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi”*

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 **“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”**,

AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventiviteti të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkëndim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës kapacitetit teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Preventivitetin e Punimeve rezulton se është

e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi. **Referuar preventivit të Punimeve** si dhe në bashkëpunim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar NP1 dhe NS9 është e nevojshme prezenca e 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi. Ku është kërkuar NS 18, është e nevojshme prezenca e 1 (nje) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder, pasi çdo matje që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit kërkon domosdoshmërisht praninë e këtij Inxhinieri. Per punimet e preventivit që lidhen me piken e licences NP 9 nevojitet inxhinieri hidroteknik. Per kategorie NP 12 nevojitet inxhinier mjedisi.

2.3.10 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë punonjës të specializuar/ të kualifikuar dhe të figurojë një listpagesat e shoqërisë për 3 muajt të fundit. Si më poshtë:

- a. Një (1) punonjës “përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i cili duhet të jetë i certifikuar “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit nr 10327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe mbrojtjen në punë” dhe VKM NR 312 datë 05.05.2010, “Për Miratimin e Rregullores për Sigurinë në Kantjer.”
- b. Një (1) punonjës specialist “Ekspert Zjarrefikes në fushën e mbrojtjes nga Zjarri dhe për shpëtim, në përputhje me ligjin nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin” shoqëruar me kontakte individuale të vlefshme, diplome/certificate leshuar nga drejtoria MZSH si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë 3 muajt të fundit.

Për të deshmuar përmbushjen e këtij kriteri , operatorët ekonomike duhet të paraqesin:

- Diplome/certificate
- Kontrata punë

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetedeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vlerësimit të ofertave duhet të dorëzojë dokumentacionin provues.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për *Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të

kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, ***punonjësi i cili është i certifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë.*** Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

AK argumenton se kërkesa për *specialistin Ekspert Zjarrfikës* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Nr. 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin".

Theksojmë se, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen: punime elektrike, saldimi etj të cilat kanë potencial të shkaktojnë aksidente me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domozdoshme prania e 1 (nje) specialist Ekspert Zjarrfikës ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin.

2.3.11. Operatorët ekonomik per realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet te disponoje edhe punonjes te specialuzar/kualifikuar si me poshte:

a)

- 1 (një) Teknik ndertimi
- 1 (nje) hekurthyes
- 1 (nje) specialist per punime betoni
- 2 (dy) murator (per ndertimin e murit te gabionit)

Per punonjesit e mesiperm te paraqiten kontrata e punes te vlefshme si dhe certifikata/diploma profesionale per secilin, certifikata /diplomat duhet te jene te leshuar nga insitucione publike/privat te licensuar, per kurset e ofruara, sipas ligjit nr 15/2017 "Per arsimin dhe formimin profesian ne RSH"

Çertifikate e sigurimit teknik e vefshme leshuar nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizma nderkombetar akreditues te njohur nga RSH.

Punetoret e mesiperm te figurojne ne listpagesat e shoqerise

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit te ofertave, duhet te dorezoje dokumentacionin e kerkuar per punetoret e mesiperm.

b) Operatori ekonomik, per realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet te disponoje edhe punonjes te specializuar/te kualifikuar si me poshte:

- Shofer kamioni 4 (kater)
- Manovrator 3 (tre)
- Automakinist 1 (nje)

Per punonjesit manovratoret/shofer, ofertuesi duhet te paraqese:

- Kontratë Individuale e Punës (*të vlefshme*),
- Leje drejtimi, çertifikatën e Aftësisë Profesionale /patente manovrimi nga DPSHTRR (**Ne rastin kur punonjësit manovrator/shofer janë të kontraktuar me kontrate pune (*respektivisht per mjetet e marra me qera*) nuk kerkohet te figurojne ne listpagesen e shoqerise**)
- Dëshmi Kualifikimi e sigurimit teknik *lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar)*.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit të ofertave, duhet të dorëzojë dokumentacionin e kerkuar per punetoret e mesiperm.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen,si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve te percaktuar ne specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit Teknik të punësuar staf Teknik (specialist, punetor) për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt,eshte kerkuar kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse/*çertifikatë e arsimit profesional*) sipas ligjitNr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh.” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga instuticione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare te Arsimit, Formimit Profesional.

2.3.12 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e konkretisht:

Deshmi per mjetet e pajisjet teknike, qe ka ne dispozicion apo mund ti vihen ne dispozicion operatorit ekonomik,qe nevojitet per ekzekutimin e kontrates.

Nr	LLOJI I MAKINERIVE	PRONESIA	SASIA Minimumi
	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 15 ton	Ne pronesi ose me qera	4 cope
•	Kamionçine kapacitet mbajtes 1.5 ton deri ne 3 ton	Ne pronesi ose me qera	2 cope
•	Fadrome me gome	Ne pronesi ose me qera	2 cope
•	Eskavator me me krahe te gjate minimalisht 17 metra	Ne pronesi ose me qera	1 cope
•	Eskavator me goma	Ne pronesi ose me qera	1 Cope
•	Autobetoniere	Ne pronesi ose me qera	1 cope
•	Autopompe betoni	Ne pronesi ose me qera	1 Cope
•	Eskavator me zinxhir minimalisht 20 ton	Ne pronesi ose me qera	1 cope
•	Minifadrome bobcat	Ne pronesi ose me qera	1 cope
•	Autobot uji	Ne pronesi ose me qera	1 cope
•	Vibrator betoni	Ne pronesi ose me qera	2 cope
•	Minieskavator	Ne pronesi ose me qera ose kontrate furnizimi	1cope
•	Gjenerator	Ne pronesi ose me qera ose kontrate furnizimi	1cope
•	Kontenier stacion levizes	Ne pronesi ose me qera	1 cope

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit të ofertave, duhet të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar për punetoret e mesiperm.

- a) Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus çertifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjeti(te vlefshme),taksat vjetore dhe certifikata e pronesise se mjetit.
- b) Per mjetet e siguruara me qera,dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (leja e qarkullimit)plus çertifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjeti(te vlefshme),taksat vjetore dhe certifikata e pronesise se mjetit si dhe duhet te shoqerohen me kontraten perkatese noteriale te qerases ,evlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.
- c) **Makinat e transportit te shoqerohen gjithashtu edhe me Leje te Transportit te Mallrave(te vlefshme),leshuar nga organet kopetente ne emer te shoqerise apo subjektit pronar te mjetit ,ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.**

- d) Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë dhe kontrollojë ne çdo kohe deri ne perfundimin e kontrates mjetet e pajisjet teknik
- e) Makinerite e mesiperme **nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera,(Deklarate nga Administratori I Shoqerise Ofertuese).**

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme eshte vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nepermjet ketyre kerkesave, ***Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kane në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi.***

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, nga ana e specialistit te fushes eshte precaktuar duke marre ne konsiderate zerat e preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë tipologjinë dhe natyrën e punimeve. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.

2.3.13 Per materialet gabion 1x1x2m dhe gabion 1x1x1m (rrjeta e telit)

1..Autorizim te prodhuesit / distributorit te autorizuar per listen e mesiperme te mallrave autorizimi duhet te permbje te dhena te plota te prodhuesit si tel/fax, email.website, kjo e nevojshme per AK ne rast verifikimi nga ana e tij.

2.Kataloget ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit per listen e materialeve te mesiperme qe do te ofrohen ne te cilen paraqitet te dhenta teknike baze te perkthyer ne gjuhen shqipe
Shenim: Fragmentet e katalogut/eve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogu si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 40, pika 6,a) *fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose*

a) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Ne projektin për sistemimin e perroit është parashikuar zgjidhje me ndertimin e gabioneve të cilat në përbërje të tyre sipas analizës teknike kanë këto materiale:

Gur kave, hekur dhe rrjet xingate për realizimin e kubikeve të gabionit

Sikundër objekti pasi të ndërtohet do të jetë në prezencë të vazhdueshme të ujërave të perroit (presion hidrostatik) është e nevojshme që cilësia e rrjetës të provohet nëpërmjet paraqitjes së autorizimeve, katalogjeve etj. Në këtë mënyrë AK sigurohet për jetëgjatësinë e objektit pasi kemi të bëjmë me ndërhyrje që i përket emergjencave civile sepse prurjet e perroit aktualisht janë shumë të rremblyeshme dhe shkaktojnë dëme të vazhdueshme në komunitetin përreth.

Shënim:

Mosdorëzimi i informacionit të saktë apo dorëzimi me të dhëna të rreme, do të konsiderohet kusht për s'kualifikim dhe/ose fillim të hetimit administrativ për përjashtimin e Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Në rast se Operatorët Ekonomikë do të paraqesin dokumentacion në gjuhë të huaj, dokumentat duhet të përkthehen në shqip dhe të noterizohen.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".